



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 4028/1 Prishtinë 16.11. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti **Besnik Gërguri** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Krahasimi i Konstruksionit me etazh fleksibile dhe konstruksionit me lartësi të etazheve të njejtë**” në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

**ABSTRAKT**

*Ky punim masteri përshkruan konceptin e katit apo etazhës fleksibile , ku do të trajtohet një objekt me kat fleksibil dhe një objekt me kat të njëjtë dhe do të bëhet krahasimi ndërmjet tyre.*

*"Etazh e butë" dhe "etazh e dobët" janë konfigurime të parregullta ndërtesash që janë një burim i rëndësishëm i seriozitetit ndaj dëmeve nga tërmeti. Këto konfigurime që në thelb kanë origjinën për shkak të vendimeve arkitekturore kanë kohë që janë të njohura nga inxhinieria ndaj tërmeteve si sizmikisht të ndjeshme.*

*Sa i përket rregulloreve sizmike të tyre gjendja e parregulltë kërkon zbatimin e konsideratave të veçanta në projektimin dhe analizën e tyre strukturore. Te shumica e rregulloreve të zonave urbane në qytetet bashkëkohore, megjithëse, aktualisht inkurajon dhe në disa raste detyron përdorimin e tyre duke mos kërkuar konsiderata të veçanta. Këto efekte janë paraqitur nga një perspektivë multidisiplinare - inxhinierike, arkitekturale dhe urbanistike- sepse trajtimi i tyre mund të arrihet vetëm me një qasje të integruar që njeh ndërvëprimin ndërmjet këtyre disiplinave. Janë analizuar shembuj të dëmtimit për shkak të këtyre efekteve.*

*Rezultatet e fituara janë paraqitur në mënyrë grafike dhe tabelare duke përfshirë këtu zhvendosjet përkatëse, si dhe zhvendosjet relative në mes kateve /interstory drifts/ , ndikimet MTN , shpërndarja e forcave në kate , shtangësia për të dy modelet me dhe pa kat fleksibil, si dhe momentet rrotulluese të paraqitur tek të gjitha çernierat plastike si dhe krahasimi i tyre në mes të dy modeleve sipas kërkesave të EC-8.*

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.